



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

(DRAFT)

METODOLOGJIA MBI PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME PËR T’U PAGUAR NGA KONSUMATORËT FUNDORË TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo metodologji përcakton përlogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo metodologji hartohet në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme” dhe nenit 19, gërma “b” e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Në këtë metodologji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- **“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.
- **Detyrimi për energjinë e rinovueshme** është një tarifë fikse që aplikohet për klientët përfundimtarë për të mbuluar kostot e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të lëvruar nga furnizuesit e tyre përkatës, e llogaritur në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme” dhe këtë metodologji.
- **“Operatori i Energjisë së Rinovueshme”** ose **“OER”** është pala kontraktuese e prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje në përputhje me ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”, nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose i mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë.

- **“Kontratë për diferencën” (CfD)** është një kontratë për mbështetje e rregulluar financiarisht ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar.
- **“Kontratë për mbështetje”** është kontratë përmes së cilës prodhuesit me përparësi i jepet mbështetje sipas ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”
- **“Kontratë për prim”** është një lloj kontrate për mbështetje ku paguhet një prim fiks (që mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të rezultatit të procesit konkurrues) ose një prim rrëshqitës (si diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës) nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për prodhuesit me përparësi mbi çmimin e tregut.
- **“Çmim i Garantuar”** është çmimi fitues i arritur në një proces konkurrues me të cilin prodhuesi me përparësi do të shesë energjinë elektrike sipas skemës së mbështetjes ose diferenca e të cilit me çmimin referencë do të mbulohet financiarisht.

“Çmimi i referencës” është çmimi i vendosur në lidhje me tregun shqiptar të ditës në avancë që operohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas përcaktimeve të skemës së mbështetjes. Llogaritja e çmimit të referencës dhe rregullat për trajtimin e çmimeve negative do të përcaktohen në dokumentet për çdo proces konkurrues dhe në kontratat e mbështetjes sipas ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Në rast se çmimi i referencës është negativ, ai do të konsiderohet zero për qëllimin e rregullimit të CfD-së.

- **“Konvertimi CfD”** është konvertimi i një MBE në një CfD në përputhje me nenin 30 pika 5, të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.
- **“Marrëveshja e blerjes së energjisë (MBE)”** është një lloj marrëveshje për mbështetje, ku një blerës i caktuar garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks.
- **Furnizues**” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.
- **“Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.
- **“Ligji për BRE-të”** nënkupton ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- **“Prodhues me përparësi”** është çdo prodhues i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë që përfiton nga një skemë mbështetëse sipas akteve ligjore në fuqi.
- **“Prodhues ekzistues me përparësi”** është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaik deri në 2 MW,

eolik deri në 3MW dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 MW.

- **“Kapitali i Punës/Kostot e likuiditetit”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
 - **“Mbështetja FiT”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
 - **“Mbështetja CfD”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
 - **“Faktori i rakordimit/korrigjimit”** ka kuptimin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj metodologjie.
2. Termat, përkufizimet e të cilave nuk renditen në pikën 1 të këtij neni, merren referencë termat dhe përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

PJESA II

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E DETYRIMIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME

Neni 4

Roli dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme

1. OER-ja do të jetë blerësi i energjisë elektrike i të gjithë prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose të mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë.
2. Energjia e blere nga OER-ja do të shpërndahej direkt në tregun e organizuar.
3. Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) do të ketë përgjegjësi kontraktore ndaj çdo prodhuesi me përparësi për mbulimin e pagesave që rezultojnë nga çdo kontratë për mbështetje sipas këtij ligji.
4. Operatori i Energjisë së Rinovueshme është përgjegjës për faturimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme tek të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të konsumatorët fundorë.
5. Operatori i Energjisë së Rinovueshme është përgjegjës për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme nga të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike të cilët ushtrojnë aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të konsumatorët fundorë dhe për pagesën e këtij detyrimi ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
6. Operatori i Energjisë së Rinovueshme ka përgjegjësinë e mbledhjes së të gjithë të dhënave nga prodhuesit me përparësi të energjisë të kualifikuar për mbështetje në lidhje me vëllimin vjetor të energjisë elektrike të parashikuar për t’u prodhuar nga energjitë e rinovueshme, periudhën dhe skemën e mbështetjes, si dhe mbështetjen në lidhje me përgjegjësinë balancuese për prodhuesit me përparësi që janë të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.
7. Pas mbledhjes së të dhënave, OER do të grumbullojë të dhënat e paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe do t’i dorëzojë në ERE për të llogaritur detyrimin e energjisë së rinovueshme, i cili do t’u ngarkohet të gjithë konsumatorëve fundorë.

8. OER me qëllim garantimin e neutralitetit të saj financiar të rregulluar do të shpërndajë kostot e disbalancave të shkaktuara prej prodhuesve me përparësi në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera ligjore fuqi, dhe do të mbledhë nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme ato kosto të disbalancave të cilat janë përtej kufijve të vendosur sipas MBE respektive për ata prodhues me përparësi të cilët kanë kufi tavan lidhur me detyrimin e kostos së disbalancave.
9. Kostot e OER do të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme fondi i të cilës do të përdoret për të mbuluar kostot e skemave mbështetëse si më poshtë:
 - a) diferencat e pagueshme ndërmjet çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e një CfD-je
 - b) pagesave të primit për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e kontratave për prim
 - c) tarifatat nxitëse për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e MBE-ve
 - d) kosto të disbalancave të cilat janë përtej kufijve të vendosur për ata prodhues me përparësi të cilët kanë kufi tavan lidhur me detyrimin e kostos së disbalancave sipas MBE respektive.
 - e) kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së OER-it, duke përfshirë, por pa u kufizuar në koston e financimit, aksesin në treg, kapitalin qarkullues dhe koston e sigurimit të rezervave për të siguruar likuiditetin financiar dhe aftësinë e pagesave të fondit të mbështetjes së rinovueshme në baza të vazhdueshme.
10. OER-ja ka të drejtën të rikuperojë çdo pagesë të paarkëtuar nga një furnizues i falimentuar, duke i ndarë këto të arkëtueshme të pambledhura me furnizuesit e mbetur në treg, në proporcion me pjesën e tregut që zë secili furnizues.
11. ERE-ja mund të vendosë:
 - a. për çdo furnizues detyrimin për të bërë parapagime të pjesës së tij të detyrimit për energjinë e rinovueshme në baza mujore, tremujore ose vjetore, sipas kësaj metodologjie për detyrimet e energjisë së rinovueshme. ERE-ja mund t'u kërkojë furnizuesve të sigurojnë instrumente likuiditeti afatshkurtra për të siguruar fondet e nevojshme për kryerjen e këtyre parapagimeve.
 - b. për OER që të sigurojë mjete monetare si hua afatshkurtër sipas nevojës për kryerjen e pagesave të pritshme për prodhuesit me përparësi.
 - c. Kostot për sigurimin e këtyre instrumenteve afatshkurtra të likuiditetit do të njihen në përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme jo me larta se normat e tregut bankar shqiptar për periudhat respektive në përputhje me këtë metodologjinë e përcaktuar nga ERE.
 - d. Nëse OER pajiset me kapital likuid paraprakisht nga fondet e shtetit, kostoja për shtetin shqiptar do të duhet të mbulohet nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme.
12. Marrëdhënia ndërmjet Operatori i Energjisë së Rinovueshme me çdo furnizues të energjisë elektrike, i cili shërben konsumatorët fundorë, me objekt mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme të ngarkuar tek të gjithë konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, do të rregullohet me kontrate ndërmjet tyre
13. Palët në kontratën e nënshkruar ndërmjet Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe Furnizuesit duhet të përcaktojnë dhe parashikojnë një kuotë vjetore të vëllimeve të energjisë së rinovueshme (të ndara në bazë mujore) që do të shitet nga çdo furnizues i energjisë elektrike tek konsumatorët fundorë si një tarifë e detyrueshme për energjinë e rinovueshme.
14. Operatori i Energjisë së Rinovueshme mban të dhëna të hollësishme për të gjitha masat që përfshijnë dhënie e mbështetjes. Këto të dhëna duhet të mbahen gjatë gjithë kohëzgjatjes

së kontratës për mbështetje dhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vjetësh, duke përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar se kushtet e kontratës për diferencë, kontratës për prim dhe MBE janë përmbushur.

15. Operatori i Energjisë së Rinovueshme do të krijojë një regjistër online të prodhuesve me perparësi të kualifikuar për mbështetje dhe do të përditësojë atë vazhdimisht.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e furnizuesve të energjisë elektrike

1. Brenda datës 1 Shtator të çdo viti, të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike do t'i paraqesin OER një parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të furnizohet prej tyre, të ndarë sipas muajve për vitin pasardhës.
2. Çdo furnizues i energjisë elektrike, i cili furnizon klientët fundorë, do të nënshkruajë një kontratë me OER për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë të energjisë elektrike
3. Çdo furnizues i energjisë elektrike për klientët fundorë është përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen nga konsumatorët fundorë të detyrimit të energjisë së rinovueshme të faturuar nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme.
4. Furnizuesi faturon vlerën e detyrimit për energjinë e rinovueshme në lekë për kWh për të gjithë klientët fundorë sipas sasisë përkatëse të energjisë elektrike të furnizuar .
5. ERE mund të vendosë për çdo furnizues detyrimin për të bërë parapagime të pjesës së tij të detyrimit për energjinë e rinovueshme në baza mujore, tremujore ose vjetore nëse vlerëson se OER ka pamundësi fondesh.
6. ERE mund të kërkojë ndaj Furnizuesve të sigurojnë instrumente likuiditeti afatshkurtra për të garantuar fondet e nevojshme për kryerjen e parapagimeve të pjesës së tyre të detyrimit për energjinë e rinovueshme, nëse vlerëson se OER ka pamundësi fondesh.
7. Kostot e arsyeshme të shkaktuara për sigurimin e këtyre instrumenteve afatshkurtra të likuiditetit mund të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme në përputhje me parimet e përcaktuara të kësaj metodologjie.
8. Në rastin se ERE do të vendosë t'i ngarkojë furnizuesit e energjisë elektrike për kryerjen e parapagimeve nëpërmjet instrumenteve të likuiditetit afatshkurtër, kostot e shkaktuara për sigurimin e tyre do të njihen në përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme sipas normave të tregut bankar shqiptar për periudhat respektive.

Neni 6

Parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi

1. Brenda datës 1 shtator të çdo viti, të gjithë prodhuesit me përparësi në operim si dhe prodhuesit me përparësi të cilët planifikojnë të vënë në funksion impiantet e tyre në vitin pasardhës, duhet t'i paraqesin OER një parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të gjenerohet nga burimet e rinovueshme të ndarë sipas.
2. Operatori i Energjisë së Rinovueshme grumbullon vëllimet totale të energjisë elektrike që parashikohet të prodhohet nga burimet e rinovueshme të paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi dhe përlllogarit shumën e parave që pritet t'u disbursohet prodhuesve me përparësi në vitin e ardhshëm.
3. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga prodhuesit me përparësi, Operatori i Energjisë së Rinovueshme parashikon buxhetin total për promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe kontratës për pagesën e diferencës për çdo prodhues me përparësi në

bazë vjetore sipas çmimeve dhe kushteve të secilës kontratë dypalëshe si dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Llogaritja e detyrimit për energjinë e rinovueshme

1. OER do të dorëzojë në ERE një kërkesë për aplikimin e tarifës në përputhje me ligjin nr. 24/2023 ‘Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet Rinovueshme’ si dhe sipas përcaktimeve të kësaj metodologjie.
2. Brenda datës 1 tetor të çdo viti, OER duhet t’i paraqesë ERE-s përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme të energjisë elektrike, vëllimet përkatëse që parashikohet të prodhohen në vitin pasardhës nga prodhuesit me përparësi si dhe shumën totale të pagesës së parashikuar që pritet të paguhet ndaj prodhuesve me përparësi prej OER.
3. ERE do të përcaktojë vlerën e detyrimit për energjinë e rinovueshme në lekë për kWh të ngarkuar në çdo klient fundor sipas sasisë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të furnizuar nga furnizuesit për këta klientë. Ky detyrim do të përcaktohet në mënyrë që të mbulojë kostot e mëposhtme bazuar në formulën dhe hapat e paraqitura në vijim.
 - A. **Mbështetja FiT** nënkupton vlerën e mbështetjes që duhet t’i paguhet kontratave FiT për prodhuesit e vegjël me përparësi ose kontratave FiT për prodhuesit me përparësi të dhëna sipas procedurave konkurruese.
 - B. **Mbështetja CfD** (Kontratë për Diferencë) nënkupton vlerën e mbështetjes që duhet t’u paguhet prodhuesve me përparësi me kontrata CfD.
 - C. **Kostot e balancimit** nënkupton kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit e vegjël të energjisë së rinovueshme ose kur është e aplikueshme kostot e shkaktuara mbi kufirin e tarifës së balancimit të vendosur në MBE respektive me prodhuesit me përparësi
 - D. **Kapitali i punës/kostot e likuiditetit** nënkuptojnë kostot e kapitalit të punës për Operatorin e Energjisë së Rinovueshme dhe kostot e rezervës/provizionit për të siguruar likuiditet në sasi të mjaftueshme dhe në vazhdimësi për të garantuar përmbushjen nga OER në kohën e duhur të të gjitha detyrimeve të CfD/MBE në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në CfD/MBE.
 - E. **Kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së OER** nënkuptojnë shpenzimet e realizuara në mënyrë të arsyshme nga OER për operacionet e saj ditore.
 - F. **Faktori i rakordimit/korrigjimit** nënkupton një faktor që rregullon diferencat ndërmjet vlerave të parashikuara të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerave të realizuara të fondit të vitit të kaluar.
 - G. Përcaktimi i grupeve të konsumatorëve fundorë (Q), përfshirë klientët familjarë dhe klientët e jo familjarë, të cilëve do t’u kërkohet të paguajnë detyrimin e e energjisë së rinovueshme, duke përlllogaritur totalin e konsumit të energjisë elektrike në kWh për grupet përkatëse të konsumatorëve fundorë për periudhën respektive.

$$RES \text{ Obligation (in Lek per kWh)} = \frac{A + B + C + D + E + F}{Q}$$

Më poshtë paraqiten hapat e llogaritjes së secilit komponent të formulës.

A. Mbështetja CfD:

- Përfshin të gjitha kontratat CfD që kanë të drejtë të marrin mbështetje përmes skemës
- Çdo kontratë CfD duhet të përcaktojë
 - i. Çmimin e garantuar në lekë për MWh. Nëse çmimi i garantuar në kontratë është i specifikuar në një monedhë tjetër (për shembull Euro), duhet përdorur një supozim i një kursi këmbimimi konservativ për të siguruar riskun e mungesës së financimit.
 - ii. Llogaritjen e çmimit të referencës së CfD në lekë/MWh që pritet në çdo orë të vitit. Këto vlerësime duhet të jenë konservative (d.m.th çmimi i ulët i tregut) për të reduktuar riskun e mungesës së financimit.
 - iii. Llogaritjen e sasisë së pritshme të gjeneruar të energjisë elektrike në çdo orë të vitit të shprehur në MWh. Këto vlerësime duhet të jenë me një probabilitet të ulët tejkalimi (p.sh. P10) për të ulur riskun e mungesës së financimit.
 - iv. Llogaritjen e pagesës mbështetjes për prodhuesit (nëse çmimi i garantuar $SP >$ çmimi i referencës CRP) ose shlyerjen ndaj OER ($SP <$ CRP) të pritshme në çdo orë të vitit.
 - v. Mbledhjen e pagesave të mbështetjes dhe ripagesave të pritshme gjatë gjithë orëve të vitit.
- Mbledhja e pagesave të mbështetjes dhe ripagesave të pritshme gjatë gjithë orëve të vitit për të gjitha kontratat CfD do të përcaktohet si më përshtë:

$$A \text{ [in Lek]} = \sum_{\text{all CfD contracts } (j)} \left[\sum_{\text{all hours } (h)} (SP_j - CRP_{j,h}) \times EG_{j,h} \right]$$

(Formula 2)

B. Mbështetja FiT:

- Identifikon të gjitha kontratat FiT që kanë të drejtë të marrin mbështetje përmes skemës
- Për çdo kontratë FiT:
 - i. Identifikimi i tarifës nxitëse (FT) në Lek/MWh. Nëse FT kontraktuale është specifikuar në një monedhë të ndryshme (p.sh. Euro), duhet përdorur një supozim i një kursi këmbimimi konservativ për të siguruar riskun e mungesës së financimit.
 - ii. Llogaritja e çmimit të referencës FiT (FRP) në Lek/MWh që pritet në çdo orë të vitit. Këto vlerësime duhet të jenë konservative (d.m.th. çmimi i ulët i tregut) për të reduktuar riskun e mungesës së financimit. Ky është vlerësimi i çmimit të tregut të produktit (P.sh një çmim referencë i lidhur me tregun e ALPEX-it, ose një shkëmbimi tjetër ose një kosto hipotetike e shmangur).
 - iii. Llogaritja e sasisë së pritshme të gjeneruar të energjisë elektrike në çdo orë të vitit të shprehur në MWh. Këto vlerësime duhet të jenë me një probabilitet të ulët tejkalimi (p.sh. P10) për të ulur riskun e mungesës së financimit.

- iv. Llogaritje e vlerës neto të mbështetjes (d.m.th FP – FRP) të pritshme për çdo orë të vitit.
- v. Mbledhja e vlerave neto të mbështetjes së pritshme përgjatë gjithë orëve të vitit.
- Mbledhja e shumave neto që priten për të gjitha kontratat FiT.

$$B [in Lek] = \sum_{all\ FiT\ contracts\ (k)} \left[\sum_{all\ hours\ (h)} (FT_k - FRP_{k,h}) \times EG_{k,h} \right]$$

(Formula 3)

- Në praktikë, kryerja e këtyre vlerësimeve për orë nga ERE mund të jetë e vështirë, kështu që këto vlerësime mund të kyhen me bazë mujore duke përdorur supozime statistikore të thjeshtuara.

C. Kostot e balancimit:

Kostot e balancimit të shkaktuara nga prodhuesit e vegjël të energjisë së rinovueshme ose kur është e aplikueshme kostot e shkaktuara mbi kufirin e tarifës së balancimit të vendosur në MBE respektive me prodhuesit me përparësi do të jenë pjesë e përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme;

$$C [in Lek] = C_1 + C_2$$

1. Për çdo kontratë ku Prodhuesi me Përparësi shet drejtpërdrejt në ALPEX:

- Llogaritja e gjenerimit total (të pritshëm AEG) në MWh në vit. Ky vlerësim duhet të jetë me një probabilitet të ulët tejkالمي (p.sh. P10) për të reduktuar riskun e mungesës së financimit.
 - i. Vlerësimi i sasisë mesatare të disbalancave (IBP) të shprehur si një % e gjenerimit total.
 - ii. Llogaritja e kostove mesatare të balancimit (BC) në lekë/MWh që pritet të përballojë Prodhuesi me Përparësi.
 - iii. Identifikimi i çmimit tavan të shërbimeve balancuese (BSCC) në Lek/MWh, nëse përcaktohet në kontratë. Kjo mund të kërkojë një konvertim të monedhës nga Euro në Lekë.
 - iv. Llogaritja e kostove të tepërta të balancimit mbi kufirin që Prodhuesi me Përparësi do të kërkojë të rikuperojë nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme.
 - v. Mbledhja e kostove të tepërta të balancimit për ata prodhues me përparësi të cilët e kanë të përcaktuar në MBE respektive kufirin e tarifës së balancimit, për të gjitha kontratat kur këta Prodhues tregtojnë energjinë eltrike drejtpërdrejt në ALPEX.

$$C_1 [in Lek] = \sum_{all\ type\ 1\ contracts\ (l)} AEG_l \times IBP_l \times \max(0, BC_l - BSCC_l)$$

(Formula 4)

2. Për çdo kontratë ku OER shet prodhimin në ALPEX:

- i. Llogaritja e gjenerimit total (AEG) në MWh të pritur në vit. Ky vlerësim duhet të jetë me një probabilitet të ulët tejkalimi për të reduktuar riskun e mungesës së financimit.
- ii. Vlerësimi i sasisë mesatare të disbalancave (IBP) shprehur si një % e gjenerimit total të energjisë elektrike.
- iii. Llogaritja e kostove mesatare të balancimit (BC) në lekë/MWh që OER pritet të ketë.
- iv. Llogaritja e kostove balancuese që OER do të kërkojë të rikuperojë nëpërmjet Detyrimit të Energjisë së Rinovueshme.
- v. Mbledhja e kostove të balancimit për të gjitha kontratat ku OER shet prodhimin në ALPEX dhe rishpërndarja e tyre të prodhuesit me përparësi, përveç atyre kostove të shkaktuara mbi kufirin e tarifës së balancimit të vendosur në MBE respektive me prodhuesit me përparësi të cilat do të mbulohen nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme

$$C_2 [in Lek] = \sum_{all\ type\ 2\ contracts\ (m)} AEG_m \times IBP_m \times BC_m$$

(Formula 5)

D. Kostot e kapitalit të punës

Në varësi të masës (ose kombinimit të masave) të miratuara, duhet të përcaktohen kostot shoqëruese që mund të mbulohen përmes detyrimit të energjisë së rinovueshme.

$$D [in Lek] = D_1 + D_2 + D_3$$

(Formula 6)

1. Nëse furnizuesve të energjisë elektrike ju kërkohet të paguajnë paraprakisht detyrimin e energjisë së rinovueshme ndaj OER-it furnizuesit do të duhet të mbulojnë kostot e ngritjes së kredisë afatshkurtër.

$$D_1 [in Lek] = (A + B + C + D + E + F) \times \frac{n_1}{12} \times K_1$$

(Formula 7)

Ku:

- $(A + B + C + D + E + F)$ është vlera e parashikuar (në Lekë) e detyrimit të energjisë së rinovueshme që furnizuesit duhet të paguajnë gjatë një viti të plotë. Vërehet se D_1 shfaqet në të dy anët e ekuacionit, kështu që duhet treguar kujdes gjatë përlllogaritjes.
- n_1 është numri i muajve që furnizuesit duhet të paguajnë në avancë detyrimin e energjisë së rinovueshme.
- K_1 është kostoja e shprehur (në % vjetore) për një furnizues tipik për të mbajtur një kredi afatshkurtër gjatë një viti të plotë.

2. Nëse OER-it i kërkohet të mbajë një garanci bankare që mbulon 6 - 12 muaj të pagesave të pritshme për Prodhuesit me Përparësi, OER do të duhet të rikuperojë kostot e garancisë bankare.

$$D_2 [in Lek] = (A + B + C_1) \times \frac{n_2}{12} \times K_2$$

(Formula 8)

Ku:

$$(A + B + C + D + E + F)$$

(Formula 9)

Ku:

- $(A + B + C_1)$ është vlera e përlogaritur (në lekë) e pagesave të pritshme për prodhuesit me përparësi përgjatë një viti të plotë. Për mbështetjen FIT (B), supozohet shuma neto.
- n_2 është numri i muajve të pagesave të pritshme që duhet të mbulojë garancia bankare.
- K_2 është kostoja (vjetore e shprehur në %) për OER për të mbajtur një garanci bankare gjatë një viti të plotë.

3. Nëse OER pajiset me kapital likuid paraprakisht nga fondet e shtetit, kostoja për shtetin shqiptar do të duhet të mbulohet. Formula e mëposhtme supozon se tarifohet vetëm interesi.

$$D_3 [in Lek] = UWC \times K_3$$

(Formula 10)

Ku:

- UWC është kapitali likuid fillestar (në lekë) i garantuar nga shteti shqiptar.
- K_3 është kostoja e kapitalit (në % (vjetore)) e shtetit shqiptar.

E. Kostot operative ditore të OER-it

Kostot e renditura nën këtë zë mbulohen nga detyrimi i energjisë së rinovueshme. Në këto kosto përfshihen:

- Qiraja
- Shpenzimet e personelit
- Kostot e IT dhe komunikimit
- Kostot e shërbimeve

- Kostot e shërbimeve profesionale (p.sh. ligjore, kontabiliteti)

F. Faktori i rakordimit/korrigjimit

Llogaritja e rakordimit/korrigjimit për periudhën T:

- Marrja në konsideratë e parashikimit të rritjes së detyrimit të energjisë së rinovueshme, shprehur në lekë, për vitin T-1 (RO (parashikim)T-1) sipas llogaritjes në vitin T-2).
- Idfentikimi i rritjes faktike të detyrimit të energjisë së rinovueshme, shprehur në lekë, në vitin T-1 (RO (aktual) T-1).
- Marrja në konsideratë e parashikimit të vendosur në skemën mbështetëse, shprehur në lekë në vitin T-1, sipas përlllogaritjes në vitin T-2.
- Identifikoni i shpenzimit faktik të skemës mbështetëse, shprehur në lekë në vitin T-1.
- Llogaritja e diferencës midis parashikimit dhe realizimit.
- Përdorimi i faktorit të rakordimit/korrigjimit në formulën e detyrimit të energjisë së rinovueshme të aplikuar për vitin T+1.

$$F_{T+1} [\text{in Lek}] = RO(\text{forecast})_{T-1} - RO(\text{actual})_{T-1} + (A + B + C + D + E) (\text{actual})_{T-1} - (A + B + C + D + E)(\text{forecast})_{T-1}$$

(Formula 11)

G. Mbulimi nga konsumatorët fundorë dhe furnizuesit

- Përcaktimi i grupeve të konsumatorëve fundorë (Q), përfshirë klientët familjarë dhe klientët e jo familjarë, të cilëve do t'u kërkohej të paguanë detyrimin e energjisë së rinovueshme.
- Llogaritja e totalit të konsumit të energjisë elektrike (TEC) në kWh për grupet përkatëse të konsumatorëve fundorë gjatë periudhës së llogaritjes. Ky vlerësim duhet të jetë konservativ (d.m.th. TEC i ulët) për të zvogëluar riskun e mungesës së furnizimit.
- Llogaritja e normës së pagesës së faturave (BPR) në % për grupet përkatëse të konsumatorëve fundorë (d.m.th. shuma e marrë nga furnizuesit si përqindje e shumës së faturuar). Ky vlerësim duhet të jetë konservativ (d.m.th. BPR i ulët) për të reduktuar riskun e mungesës së financimit.
- Vlerësimi i probabilitetit të mospagimit të furnizuesit (SDP) në % përgjatë periudhës së llogaritjes.

$$Q [\text{in kWh}] = TEC \times BPR \times (1 - SDP)$$

(Formula 12)

- Në fund të çdo (periudhe likuidimi) ERE do të nxjerrë një vendim për vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme të shprehur në Lekë për kWh që duhet paguar nga çdo konsumator fundor i energjisë elektrike (gjatë periudhës pasardhëse të likuidimit).
- ERE do të komunikojë vendimin në mënyrë transparente të gjithëve furnizuesve të energjisë elektrike dhe klientëve fundorë dhe do ta publikojë atë në faqen e saj zyrtare si dhe në shtypin e shkruar kombëtar për 3 (tre) ditë rresht.

Neni 8
Faturimi dhe pagesa e detyrimit për energjinë e rinovueshme
dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi

1. Çdo faturë e energjisë elektrike e faturuar nga furnizuesi i energjisë elektrike për një konsumator fundorë do të përfshijë detyrimin e energjisë së rinovueshme të faturuar shprehimisht nga furnizuesi i tyre i energjisë elektrike.
2. Çdo prodhues me përparësi do të faturojë Operatorin e Energjisë së Rinovueshme me shumat e detyrimeve në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në MBE/CfD.
3. Çdo furnizues duhet të paguajë pjesën e tij të detyrimit të energjisë së rinovueshme paraprakisht te OER. OER do të llogarisë pjesën e secilit furnizues për detyrimin e energjisë së rinovueshme në raport me pjesën e parashikuar të tregut të secilit furnizues. Në varësi të periudhës së përlllogaritjes së detyrimit të burimeve të rinovueshme si dhe financimit të likuiditetit të nevojshëm nga OER për kryerjen e pagesave ndaj prodhuesve me përparësi, do të përcaktohet dhe periudha e paradhënies së detyrimit të burimeve të rinovueshme nga furnizuesit e energjisë elektrike.
4. Kostot e arsyeshme të bëra për sigurimin e instrumenteve të tilla afatshkurtra të likuiditetit mund të mbulohen nëpërmjet detyrimit për energjinë e rinovueshme. OER do të informojë paraprakisht ERE-n për këto instrumente afatshkurtra likuiditeti dhe normat përkatëse të sigurimit të tyre sipas secilit burim.
5. Në rast të diferencave ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve të tregut, OER do të kryejë një rakordim [pas çdo muaji ose çdo tre-mujori të përcaktuar me vendimin e ERE-s dhe do të rregullojë grupin e ardhshëm të pagesave në përputhje me rrethanat]. OER do të informojë ERE-n për rakordimin e të dhënave sa më shpejt të jetë e mundur.
6. Pagesa e faturave të lëshuara nga OER dhe të pranuar nga furnizuesit e energjisë elektrike do të bëhet brenda 5 (pesë) dite pune pas pranimit të faturës mujore të lëshuar nga OER në përputhje me kushtet dhe përcaktimet e kontratave.
7. Pagesa e faturave të lëshuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe të marra nga OER do të bëhet në përputhje me termat dhe kushtet e CfD/MBE-ve përkatëse.

Neni 9
Rregullimet e detyrimit të energjisë së rinovueshme

1. ERE do të llogarisë diferencat midis vlerave dhe sasive të parashikuara dhe të realizuara për promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme gjatë periudhës kalendarike të mëparshëm duke integruar një faktor rakordimi/korigjimi (F) në përputhje me nenin 7 të kësaj metodologjie.
2. Rezultatet do të publikohen për të gjitha palët e interesuara dhe do të përfshihen në rishikimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme në periudhën e ardhshme rregullatore.

Neni 10

Kufiri maksimal për instrumentet afatshkurtër për likuiditet nga furnizuesit dhe nga OER

1. Në rast se ERE gjykon se llogaritja e pagesave afatshkurtra të likuiditetit për furnizuesit për një ose më shumë periudha likuidimi do të rezultojë në një barrë joproporcionale për klientët fundorë ose kur gjykon se ka mungesë të konsiderueshme të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike me shumicë ose pakicë, e cila mund të krijojë pengesa për hyrjen e furnizuesve të rinj, ERE mund të përcaktojë kufirin maksimal duke vendosur një shumë maksimale për instrumentat afatshkurtra të likuiditetit për çdo furnizues bazuar në pjesën e tij të tregut ose do të udhëzojë OER për të siguruar alternativa të tjera të krijimit të likuiditetit të nevojshëm sipas rasteve në vijim:
 - (a) duke marrë mjete monetare në formën e huave afatshkurtra për të mbuluar shlyerjen e pagesave të pritshme për prodhuesit me përparësi, kosto të borxhit të cilat OER do të duhet t'i recuperojë nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme.
 - (b) të përdorë kapitalin e saj likuid në rastin e mjaftueshmërisë së tij për shlyerjen e pagesave, ku kosto e kapitalit të OER do të mbulohet nëpërmjet detyrimit të burimeve të rinovueshme.
2. ERE mund të vendosë të bëjë një vlerësim të thelluar të tregut të energjisë elektrike dhe të ndikimit të detyrimit të energjisë së rinovueshme në çmimet e klientëve fundorë.
3. Në përcaktimin e kufijve maksimalë për likuiditetin afatshkurtër të furnizuesve të energjisë elektrike, apo të koston së borxhit ose koston së kapitalit të OER, ERE do të mbështetet në normat e tregut bankar shqiptar për periudhën respektive.

PJESA III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Dispozitë kalimtare

1. Deri në krijimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, detyrat e tij kryhen nga furnizuesi në tregun e lirë (FTL). Gjatë kësaj periudhe, furnizuesi në tregun e lirë do të kryejë detyrat për llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.
2. Prodhuesit me përparësi do të dërgojnë pranë furnizuesit të tregut të lirë jo më vonë se 2 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, vëllimet përkatëse që parashikohet të prodhohen për periudhën e mbetur të vitit aktual.
3. Të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike do t'i paraqesin furnizuesit të tregut të lirë një parashikim të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të furnizohet prej tyre jo më vonë se 2 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie për periudhën e mbetur të vitit aktual.
4. Furnizuesi i tregut të lirë, do të dorëzojë në ERE një kërkesë për aplikimin dhe për llogaritjet e detyrimit të energjisë së rinovueshme për herë të parë, 3 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie për periudhën e mbetur të vitit aktual.

Neni 12

Rishikim i jashtëzakonshëm i detyrimit për energjinë e Rinovueshme

1. Kur ERE vlerëson se ka një devijim të tepruar ndërmjet vlerave të parashikuara dhe të realizuara për qëllimin e llogaritjes së detyrimit për energjinë e rinovueshme sipas neneve

7 dhe 9 të kësaj rregullore, ERE mund të kryejë një rishikim brenda periudhës rregullatore të detyrimit për energjinë e rinovueshme.

2. Kushtet dhe procedurat për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për energjinë e rinovueshme do të miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

Neni 13

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshjeje për shumat e detyrimeve, palët kontraktuale në marrëveshjet ndërmjet Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe prodhuesve me përparësi ose në marrëveshjet ndërmjet Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe furnizuesve të energjisë elektrike, fillimisht do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur konfliktin me mirëkuptim të ndërsjellë.
2. Nëse nuk gjendet zgjidhje për një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve kontraktuale të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ERE do të veprojë si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Nëse sërish nuk gjendet një zgjidhje, palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 14

Rishikimi dhe ndryshimi i metodologjisë

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE, në përputhje me Rregulloren për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.